



Republika e Kosovës
Republika Kosovo
Republic of Kosovo

<http://kk.rks-gov.net/istog/>



Komuna e Istogut
Opština Istok
Municipality of Istog

Tel: 038/200 438 14

PROJEKT- RREGULLOREN PËR KATEGORIZIMIN E KLUBEVE

P R O C E S V E R B A L

Nga diskutimi publik për Projekt- Rregulloren për Kategorizimin e Klubeve mbajtur më:
15.12.2022, në Sallën e Kuvendit të Komunës, filluar me punë në ora **11⁰⁰**

Në Dëgjim ishin të pranishëm:

1. Elianë Blakaj, Drejtoreshë për Kulturë, Rini dhe Sport
2. Kabashi, Drejtor për Administratë Komunale
3. Ardon Arifaj, Zyra e Kryetarit

Diskutimi ishte i hapur për të gjithë qytetarët e pranishëm të cilët ishin ardhur për diskutimin e këtë rregullore.

Diskutimin e hapi dhe e kryesoi, për Projekt- Rregulloren për Kategorizimin e Klubeve Drejtoresha për Kulturë, Rini dhe Sport , znj. Elianë Blakaj.

Drejtoresha për Kulturë, Rini dhe Sport , znj. Elianë Blakaj – përshëndeti të gjithë të pranishmit në këtë mbledhje dhe hapi diskutimin publik për Projekt- Rregulloren për Kategorizimin e Klubeve dhe për këtë mbledhje propozoi këtë rend dite:

R E N D D I T E

1. Njoftimi për Projekt- Rregulloren për Kategorizimin e Klubeve,
2. Propozimet e qytetarëve për draft-programin,
3. Pyetje dhe Përgjigje

Drejtoresha për Kulturë, Rini dhe Sport , znj. Elianë Blakaj, – Të nderuar qytetarë, po fillojmë me seancën e diskutimit publik me qytetarë, sot jemi këtu për Projekt- Rregulloren për Kategorizimin e Klubeve dhe kisha dashtë me ju falënderu për pjesëmarrjen, konsideroj qe pjesëmarrja e klubeve nuk është e kënaqshme nga ana ime për shkak së çdo pjesëmarrës mundet me kontribuar më shumë që kjo rregullore të jetë Procesverbali

e plotësuar dhe e rregulluar në mënyrën më të mirë të mundshme për secilin klub në Komunën tonë dhe rrjedhimisht do të ishte mirë që në fund të përkrahet secili klub, fjalën po ua kaloj juve kush dëshiron, unë jam këtu nëse ka nevojë për sqarime ose me elaboru pra Rekomandimet dhe pyetjet që vijnë nga ana juaj dhe përmirëson këtë rregullore jam e gatshme me shqyrtu me komisionin të cilën e kemi përfunduar këtë draft-rregullore.

Faruk Shala, përfaqësues i Klubit Hendboll të Femrave të Istogut, Përsëritet të pranishmit, së pari faleminderit për ftesën edhe vërtet edhe për mu është shqetësuese mos pjesëmarrja e Klubeve Sportive, mbase që jemi më pak sot po flasim më shumë vetëm mos të bëhemi të tepërt për juve por nuk kemi zgjidhje tjetër.

Para se me hy te rregullorja mbase nuk kanë qenë klubet sportive dhe kështu shumë zyrtar unë personalisht i kisha thënë disa fjalë edhe pse është e rëndësishme me kanë pjesëmarrës të gjitha klubet dhe shumë zyrtar të tjerë sepse Sporti në komunën tonë ka pasur një ecure ashtu si e ka pas më shumë vështirësi këtu qenkemi profi Xhevat dhe unë që kemi kaluar të gjitha sfidat.

Rregullorja për kategorizimin e klubeve sportive me aq sa kam pas mundësi dhe kohë me shiku ka shumë gjëra të mira edhe pse sigurisht që ka shumë hapësirë për tu adaptuar në rrethanat që mi ra përshtati komunës së Istogut në kuptimin që çdo komunë i ka specifikat e veta, këtë vit e kemi pasur një ndarje të buxhetit që ne si klub i hendbollit ndoshta kemi qenë më të pakënaqurit por që ne thjesht nuk kemi asnjë lloj ambicie që pakënaqësinë tonë me paraqit nëpërmjet rrjeteve sociale, sepse këtu është vendi ku duhet me fol, ma shume jam i brengosur që i kom ndij do fjalë të klubeve tjera edhe të do zyrtareve të rinjë që nuk din qysh shkojnë rrjedhat po unë po du me u lidh me ato që jemi kampion Kosovë dhe fitues të Kosovës dhe na e kemi mor në buxhet që ne realitet në superlig të Kosovës prej gjitha klubeve që janë 12 d.m.th. masë pakti kemi mor na dhe është shembull i keq që kampioni i Kosovës nga Komuna e vet përfiton më së pakti, në krahasim me gjithë konkurrentet e vet. Por si do që të jetë çka pata me thanë e thash edhe pse kjo nuk na ka lëndu shumë sepse mund të mos ketë buxhet të mjaftueshëm sepse të gjithë jemi të vetëdijshëm që Komuna e Istogut nuk e ka pasur buxhetin e mjaftueshëm që me ju dal në ndihmë gjitha këtyre klubeve në mënyrë të merituar në Komunën e Istogut. Ne asnjëherë nuk kërkojmë me qen të mbështetur vetëm ne dhe jo klubet tjera sepse me kalimin e kohës krejt kanë me i pas rezultatet se synimi i tyre është që ai, dhe kisha pas qejf me pas parasysh disa zyrtarë komunal që kanë qenë nëpër komisione që ka pas fjalë që klubi i hendbollit ka hendbollist prej jashtë e nuk pe ngrit sportin e Istogut e kesi gjëra. E kom për obligim me ju than sot që mundet mos me pas buxhet por këso gjana nuk është mire me than për disa arsye sepse tanë e dimë që për në periudhë të gjatë kohore klubi i basketbollit e ka ndërpre për një kohë aktivitetin edhe për një kohë të gjatë kohore ka qenë vetëm klubi i futbollit, Gania, Rrahim Shatri me atë Klubin e Karatesë edhe na si Klub, d.m.th. nuk është mirë neve me na than se dalim keq se i vetmi grup sportiv që ka bërë kampion, ka fituar trofe në Kosovë d.m.th. në Istog, është Klubi i hendbollit gjithsej 21 trofe, e prej këtyre 21 trofeve, afër 12 janë me gjenerata të reja, nuk ka trofe në Kosovë që klubi i hendbollit nuk e ka fitu, deri tani janë 56 hendbollistë që janë anëtarë të reprezentacionit të Kosovës, dhe d.m.th. nuk është mire me fol pa i dit rrjedhat se çka është bërë sepse ndoshta dikush është krejt i pa informuar edhe për një moment duhet me vendos për buxhet ose diçka edhe paraqet kesi gjana që mu nuk më kanë pëlqyer, duke i përfshirë edhe disa klube sportive, edhe cilido qoftë ai duhet me pas synim rezultatet e veta edhe me përfitu buxhet sa të mundët për veti, se nuk i ndihmon askujt me u shpreh kështu, se duhet në bazë të meritave edhe

rangut të garave secili klub me përfitu. Kjo ishte një pjesë që kom pas dëshirë me than kaheër por për shkak të rrethanave që thash më herët na nuk kemi qenë fort të kënaqur me ndarjen e buxhetit nga viti i kaluar por ajo pse na nuk kemi reaguar asnjëherë në media është kjo arsyeja edhe qeto të fundit po du me than, misioni i klubit të hendbollit të Istogut është që me përfaqësuar Komunën e Istogut dhe qytetarët e saj në mënyrën sa më mirë dhe nuk është mision i tij me ba propagandë negative ndaj Komunës ose ndaj qytetit të Istogut. Tash po flasim për rregulloren, thash edhe ma herët që rregullorja ka shumë gjana pozitive po ndoshta mundet me u harmonizuar edhe në mënyrë ma të mirë, d.m.th. te kriteret unë mendoj që kriteri nr. 1 duhet të jetë niveli i garave dhe rezultatet e arritura, sepse vetëm me gjana të duhura mund të arritet rezultatet më të mëdhaja, e pash që niveli i par kategorizimi i sporteve tradita e klubit, nder klubet e para që u formuar është klubi i futbollit dhe i basketbollit por në periudhën e okupimit klubet nuk kanë funksionu dhe unë nuk e di Elianë këto a janë vetëm si kriteret a edhe për nga rëndësia a bartin pikë sepse unë nuk e shoh që ish dashtë me kanë niveli i parë, sepse tradita vlen për shembull si klubi i Prishtinës që ka marrë pjesë në lig të parë të Jugosllavisë dhe i ka disa trofe dhe se di sa herë kampion Kosovë, kjo është traditë e jo vetëm nëse je themeluar para disa vjetëve. Niveli i garave duhet të jetë para nr. të sportisteve sepse mundet një klub me pas shumë sportist po jo kualitet se mundet mos me pas asnjë sukses prej tij. Te kategorizimi i sporteve ju e kishit planifikim deri me dt.15 Janar unë mendoj që duhet me u marr për bazë kategorizimi i sporteve nga komiteti olimpiq dhe mendoj që kjo është baza e parë dhe kjo është kompetencë e komitetit olimpiq sipas rregullores për sport dhe kur të bëjnë shpalljen komiteti olimpiq ne bazë të kësaj duhet edhe klubet në Istog me marr pikë se nuk mundemi me kanë kundër rregulloreve të ministrisë së kulturës rinisë dhe sportit. E tani mblodhën të gjitha pikët dhe dalin pikët e përgjithshme për secilin sport. Rezultatet e arritura ne klubet ekipore po me duket Eliane e ki 5a, e ki një gabim se është e para niveli i parë 10pikë dhe i dyti 8 pikë, dhe sa pe kuptoj unë është gabim teknik. Unë mendoj që këtu mundet me na ndihmuar edhe profi Xhevat se fituesit e titullit dhe kupës se Kosovës vlerësohen me pikë të njëjta dhe mendoj që këtu duhet me be një dallim sepse çdo federatë sportive titulli i kampionit të Kosovës është garë e rëndësisë së parë ndërsa kupa e një niveli më poshtë, sepse kampionati është shumë më i gjatë dhe ka më shumë ndeshje, sepse ndryshon rëndësia nëse je bo kampion edhe nëse e ke fitu kupën. Rezultatet në pjesëmarrjet individuale në kampionat olimpiq dhe kampionat botëror, medaljet e këto, janë të rregullume me rregulloren për kategorizim të sportisteve dhe trajnerëve dhe marrin pjesë përfaqësueset e jo klubet, na kemi edhe kampion olimpiq edhe botëror, Majlinda Kelmendi, Nora Gjakova edhe trajneri Driton Kuka veq i kanë arrit këto rezultate, edhe na e dimë në bazë të shtetit se çka ju taku, edhe këtu marrin pjesë përfaqësuesit dhe jo ekipet kuadri i Istogut p.sh. nëse një sportist i Istogut arrin me fitu ndonjë shpërblim na duhet me përkrah se e meriton. Na duhet me shqyrtu këto me harmonizu me Ministri, mundesh me i jep pikë ama jo këto pikë se këto janë të përcaktume me rregullore, dhe nuk e kom pa që janë të përfshimë kupat evropiane që klubet tona marrin pjesë, p.sh. klubi i hendbollit te Istogut që 6vjet merr pjesë po nuk do të thotë që në të ardhmen nuk mundet me marr pjesë një klub prej një federate tjetër qoftë futboll, basketboll etj., kështu që mendoj që në rregullore ish dashtë me u përfshi edhe pjesëmarrja e skuadrave në kupa të Evropës sipas federatave përkatëse, d.m.th. sportit, sepse Elianë se di qysh doni me na mbështet në kupa të Evropës nëse nuk jemi të përfshim. Përderisa na thirrem në kategorizim të klubeve, këtu po shkruan rregullore për kategorizimin e klubeve sportive, na nuk mundemi kampionatin botëror në lojëra olimpike sepse merr pjesë përfaqësuesja jo klubi.

Drejtoresha e Kulturës rinisë dhe sportit, Eliana Blakaj: Neni 4 pika 3 theksohet rezultati sportiv që arrin një klub i sportit individual njihet si rezultat i sportit ekipor me kusht që ky rezultat të jetë i pranuar në federatën përkatëse të sportit.

Faruk Shala, përfaqësues i Klubit Hendboll të Femrave të Istogut, unë prape insistoj pjesëmarrja e klubeve në kupat përkatëse evropiane duhet me u përfshij këtu. Te rregullimi i dokumentacionit në fund e kom pa ama nuk e di a është obligative, te auditori i jashtëm për mu është shumë në rregull se na e kemi qarkullimin vjetor 150 mijë euro edhe jemi të obliguar edhe nëse ju nuk na obligoni, por është e vështirë për klubet që janë ma të vogla he janë nën 10 mijë euro dhe mendoj që këto klube mundën me kanë të dëmtuara sepse atyre atë buxhet u 'a merr auditori edhe çka po ju mbetet atëherë, mirëpo kjo vlen ma shumë ndoshta për klubet individuale. Sepse na e kem me ministri si të kalojnë më shumë se 10 mijë euro të hyra vjetore duhet raport i auditorit nga klubi, këta e thash për me i ruajt klubet që kanë buxhet të vogël. Faleminderit.

Drejtoresha e Kulturës rinisë dhe sportit, Eliana Blakaj: Unë po vazhdoj me pikat që i theksove secilën prej tyre për me të jep përgjigje. Po ndalna te buxheti në fillim, si klub i hendbollit të femrave që na ka bo krenar jo vetëm komunën por gjithë Kosovën ashtu edhe gjitha klubet që janë pjesë e Istogut, mendoj që meritojnë përkrahje edhe më të madhe por DKRS-ja ka vetëm 60.000 euro, për pjesën e rinisë, kulturës dhe sportit, mendoj që 1/3 e buxhetit me shku vetëm për një klub mendoj që nuk është një përkrahje e keqe, pra për klubin e hendbollit të femrave. Ndërsa rregullorja është harmonizuar me rregulloren qendrore, u dashtë me ju përshtat secilit klub, për këtë arsyeje jon përfshi edhe traditat dhe rezultatet dhe gjitha këto pikat që theksohen tek kriteret, ndoshta jemi keqkuptua prof. Kur the që ndoshta është me rëndësi me kanë nivelin i garave para nr. të sportistëve, kjo nuk luan rol sepse këto janë të ndara me pikë dhe nuk ka rëndësi nëse niveli i garave është ma herët i ranguar se niveli i sportistëve për shkak se përderisa janë pikë theksohet secila prej tyre se ka sa pikë kanë vlerë, andaj në këtë rast numri i sportistëve i ka max 4.0 pikë dhe tek niveli i garave është 6.0, d.m.th. sak rëndësi që kjo është nivel ma poshtë dhe kur jemi te kjo si ankes i veçantë e theksuar për këtë, për nenin 4 dhe pe theksoj prapë se na kem me u mbledh prap si komision dhe gjithçka që lejon ligji dhe rregullorja kem me harmonizuar, për këtë arsye jemi sot në dëgjim publik.

Faruk Shala, përfaqësues i Klubit Hendboll të Femrave të Istogut, sa kom pas rast me ndegju , më duket që Alia ka thënë që kjo rregullore është e marr nga një Komunë tjetër, me doket prej Prizrenit me ka thanë.

Drejtoresha e Kulturës rinisë dhe sportit, Eliana Blakaj: e vetmja Komunë në Kosovë që e ka kategorizimin e klubeve në nivel lokal është Komuna e Prizrenit.

Faruk Shala, përfaqësues i Klubit Hendboll të Femrave të Istogut, por nuk ka rëndësi kjo, por ajo çka po du me thanë është që kur merr edhe e shikon këtë rregullore, i jep disa mendime dhe vërejtje, por vlerësimi jem është pozitiv jo negativ. Edhe krejt çka thash unë jon vërejtje të vogla, edhe nuk e ndryshon pjesën strukturore të kësaj rregulloreje, por thash që për me e bazua në bazë të specifikave të veta, si të gjitha Komunat tjera. P.sh. Klubi i Prizrenit e bazon në traditë se Prizreni e ka pas Lirinë e Prizrenit që ka qenë klub me nam në Jugosllavi dhe për këtë është e vendosur këtu, për këta po them edhe na me ja përshtat vendit tonë. Edhe për atë temën që the nuk pajtona

Eliane, ndoshta ma mire mos me fol hiq, se këtyre ju interesojnë gjana tjera për ndarjen e buxhetit.

Xhevat Camaj: Faleminderit për ftesën, sot nuk kam ardhur si përfaqësues i asnjë klubi, unë sa e pashë për një kohë të shkurtë, rregullorja përfshin shumë gjana dhe duhet me pas vija vertikale nga niveli qendror që me harmonizu me atë të nivelit lokal. Unë ma shumë kom ardhur me fol për rregullore se për buxhetin edhe pse këtu ka shumë, pajtohem me prof.. Faruk, por do të ceku edhe diçka, në rregullore nuk kam pa askund që ceket formimi dhe përkrahja e klubeve të reja që është shumë më rëndësi, për traditë, themi që duhet me përcjell, se p.sh. unë jam i paraluftës dhe kam dhënë kontribut me shumë profa të tjerë, p.sh. traditën e klubit të futbollit dhe të basketbollit nuk duhet ti humbim absolut, është dëm me e humb, mirëpo do ndalem te disa gjana, mendoj që komunat nuk mundën me i mbajt klubet, aty te masiviteti mund të pajtohem edhe nga rangimi i sporteve edhe pse në komitetin olimpiq është i rangum gjudo si sport i parë ne bazë te rezultateve dhe është mirë që është kategorizuar, pajtohem me kategorizim. Nuk kam shumë vërejtje, duhet klubet e mëdha në komunën tonë duhet të gjejnë zgjidhje përmes donacioneve, se nuk mundet komuna me ndihmuar një klub, Komuna duhet me na ndihmu në infrastrukturë me logjistikë, dokumentacion. Unë sot kom ardhur për rregullore dhe për nivel. Istogu është mirë me klube të reja dhe duhet pas parasysh që sportet tjera nuk mundet me u krahasuar me sportin e futbollit, dhe unë sot kom ardhur me kontribuu këtu edhe me shti pikën e përkrahjeve të klubeve të reja., p.sh. klubi i tenisit dhe noti, të cilët janë duke i bër disa hapa, po nuk kem pas shumë kohë.

Faruk Shala, përfaqësues i Klubit Hendboll të Femrave të Istogut: Po ju drejtona Drejtoreshës Elianës dhe Profit, unë veç çka po dëshiroj me diskutu është që na si klub asnjëherë nuk kem pas pakënaqësi, e thashë në fillim pse na pat mbet hatri në disa njerëz që vërtet nuk kanë pas njohuri, një gja është evidente, futbollit ka shumë donator, dhe sportet zakonisht sportet me dorë mbështeten nga Komunitat, edhe meritat klubi i hendbollit i ka prej Komunitas që shumë vite. Unë vetëm ceka që nuk ka pas buxhet dhe thash më u përkrah të gjithë. Por qeto gjana që un i kam ndegju na kanë ba me u ndije keq sepse njerëzit nuk e din historinë, me i fitu 21 trofe një klub i qytetit te Istogut, që as një qytet tjetër si ka fitu d.m.th. këtu ka diçka edhe pse nuk është mire me than kështu, se kom qejf edhe sportet tjera me fitu trofe, andaj nuk bon na mes veti me bo propagandë.

Niman Beqiraj - Unë sot së pari nuk jomë i kënaqur me nr. e pjesëmarrësve këtu, unë e kom pa drejtoreshën që ka taku shumë klube sportive dhe është mirë që i ka taku mirëpo ndoshta edhe u dashtë me ju tregu gjatë kësaj kohe që është një rregullore ose me ju dërgu email, që edhe ata me jep kontribut. Unë i kom disa pjesë që ndoshta kisha mujt me kontribu edhe pse normal nuk krahasona me Farukun e profin Xhevat se këta e dinë shumë ma mirë, mirëpo unë isha ndal te kriteret për kategorizim neni 4, unë e shoh si nivel te parë kategorizimin nacional të sporteve, se dëgjova profen Xhevat që tha futbollit është sport në veti, andaj futbollit merr pikë më së shumti, andaj është meritör.

Faruk Shala, përfaqësues i Klubit Hendboll të Femrave të Istogut: Nuk është që është meritör, por Profi Xhevat tha se federata futbollit është federatë në veti se gjithmonë thuhet futbollit dhe sportet tjera dhe futbollit ka avancim gjithmonë më shumë dhe më e fuqishme si organizatë se komiteti olimpiq. Futbollit në Kosovë është normal ma

masovik dhe përcjellët më shumë, sepse veç futbollit në Kosovë i ka 3liga, d.m.th. me ligj qekjo rregullore e kish nenin që fuqizon futbollin.

Niman Beqiraj - Faleminderit prof. unë e thash qe nuk mundem me ndërhy si Komune se është kategorizim nacional i sporteve, si kategorizim i fyte kisha pas qef me kanë niveli i garave që klubi merr pjese, kriter të tret kisha vendos rezultatet e arritura sportive, kriter te katërt është numri i sportistëve të regjistruar, kriter të 5-të kisha vendos ngritjen e kapaciteteve, pra me ju ndihmu që ata me pas rritje në nxjerrjen e talenteve të rijnë, pikë e 6 kisha vendos angazhimin e përfaqësuesve të Kosovës, pikë 7 pjesëmarrjen e klubeve në aktivitete dhe gara, pika 8 organizimi i garave dhe aktiviteteve, pikë 9 traditën e klubeve sepse na kemi klubin Ballkani qe është themeluar vonë mirëpo na ka bere krenarë.

Drejtoresha e Kulturës rinisë dhe sportit, Eliana Blakaj: prap pe ritheksoj se nuk është në pyetje këtu kriteri, se nuk ka rendësi cili kriter është vendos i pari, është më rëndësi numri i pikëve që është theksua për secilën.

Niman Beqiraj - në rregull atëherë vazhdojmë më nenin 5, ku shoh që komisioni përbehet prej 5 anëtareve, një anëtarë nga DKRS-ja dhe tre anëtarë nga institucioni, atëherë po i bien që 4 anëtarë janë nga institucioni sepse edhe DKRS-ja është pjesë e institucionit.

Drejtoresha e Kulturës rinisë dhe sportit, Eliana Blakaj: atëherë kjo është bërë me qëllim që një me qenë detyrimisht nga drejtorati dhe siç e dimë drejtorati nuk ka më shumë zyrtarë dhe te tjerët me qenë nga institucioni.

Niman Beqiraj - Pse jo nga asambleja p.sh.?

Drejtoresha e Kulturës rinisë dhe sportit: Besoj se ka qenë e paraparë që të bëhet përzgjedhje si institucion brenda komunës,

Niman Beqiraj - ndërkaq tek tabela poentuese unë pajtohem me Farukun kur tha që rezultatet e arritura në sportet ekipore, me qenë kampion edhe me fitu kupën ka dallime të mdhaja, të jesh kampion i Kosovës ka shumë gara, derisa të bëhesh kampion ndërkaq nëse je fitues i kupës atëherë ne formën e eliminimit bien, d.m.th. ma pak ndeshje, pra shpenzimet i kanë ma të mdhaja ata që marrin pjesë në gara. Tek angazhimi në përfaqësuese të Kosovës dhe për çdo trajner të angazhuar duhet me pas diferencë sepse sportistet munden edhe me u dëmtuar, p.sh. një sportiste e Istogut mundet me pas një lëndim që mundet me i kushtu më pas. Te dokumentacioni, i keni poentua p.sh. me 2pike 3pike mirëpo nëse dikush është kampion, p.sh. ka fitu titull olimpik dhe ka fitu 26 pike pse ne këtë rast me poentu?

Faruk Shala, përfaqësues i Klubit Hendboll të Femrave të Istogut: defekti i këtij debati është që nuk kanë ardhur të gjithë, u dashtë me kanë edhe Fikreti se edhe reagon edhe ka përvojë ma gjatë në ministri. Te auditori edhe njëherë pe përsëriti nuk ka të bëjë me mu, ka të bëjë me klubet që kanë buxhet vjetor t vogël.

Drejtoresha e Kulturës rinisë dhe sportit: Raporti i punës tu përfshi edhe raportin financiar, nëse një klub nuk e sjell këtë, nuk është që diskualifikohet por vetëm i heqën - 2 pikë, d.m.th. nuk të penalizon.

Niman Beqiraj - P.sh. Te dokumentacioni, nuk është e rëndësishme nëse je kampion olimpiq, mundesh mos me pru asnjë prej këtyre sepse i ki 26 pikë edhe përfiton. është mirë me pas një plan të veprimit me ditë çka dëshiron me be kur e poenton, me pas procesverbalet etj.

Drejtoresha e Kulturës rinisë dhe sportit: për këta që poentohen nuk mundesh me ju bo obligative, pra një klub sa ma i rregullt që është merr ma shumë pike, p.sh. nëse një klub fiton vetëm 2.000 euro me ja bo obligative me pru raportin financiar nga auditori.

Niman Beqiraj - mirëpo procesverbali i mbajtjes se kuvendeve të klubeve, me doket bahet vetëm një herë, kur themelohet një klub.

Drejtoresha e Kulturës rinisë dhe sportit: Jo, ajo bahet çdo 4 vjet ose është e theksuar kur mbahet kuvendi, varësisht nga statuti i organizatës.

Faruk Shala, përfaqësues i Klubit Hendboll të Femrave të Istogut: vetëm pak, çdo 4 vjet është kuvendi i rregullt zgjedhor, kurse raporti normalisht 6 muaj- 1 vjet duhet me pas kuvend të punës dhe klubet e mdhaja zakonisht i bëjnë këto. D.m.th. kuvendet e punës janë ligjërisht të obligume mi mbajt ma shpesh, jo ashtu qysh i mbajnë.

Drejtoresha e Kulturës rinisë dhe sportit: Nëse ka edhe diçka?

Faruk Shala, përfaqësues i Klubit Hendboll të Femrave të Istogut: Qe po e marr një shembull, zakonisht përplasjet që janë në komuna ndodhin në mes klubeve individuale dhe kolektive sepse specifikat i kanë shumë të ndryshme dhe nuk mundem me i shti një thes. Sepse me u kualifikuar një sport ekipor në kampionat qofte evropian qofte botëror është shumë e madhe, mirëpo në të njëjtën formë mundesh me u bo kampion edhe individualisht por me u be kampion në sport kolektiv është arritje edhe punë shumë më e madhe.

Drejtoresha e Kulturës rinisë dhe sportit: Nëse ka edhe diçka?

Taulant Buleshkaj - Unë ju përgëzoj për këtë kategorizim të rregullores të klubeve të sporteve, në bazë të kësaj çka pamë, pat shumë sene te mira. Sukseset që ka pas klubi i hendbollit edhe buxheti që ju ka nda, gjithmonë prej tjerëve ju kanë drejtuar me gisht. Ndoshta ka diçka qe duhet me përmirësua mirëpo ne bazë të kësaj rregullore secili klub para se me pru projektin e dimë sa kem me përfitu prej kuvendit komunal. Sa i përket traditës së klubit, mire tha profi ma shumë duhet me u merr sukseset e atij klubi, se ka klube që janë themelu moti por nuk kanë pas suksese. Po ashtu rinia duhet me u aktivizu me sporte pak ma shumë. Kur u hap shkolla e hendbollit, për neve u kanë njëherë diçka prej punëve ma te mira, edhe pse sukseset, kupat jon tjetër, ama shkolla ka qenë prej gjerave e ma te mira. Edhe diçka që vlen të theksohet është që duhet me qenë të regjistruam ne federatë, se na kem veç numra ose ka X klube që kanë vetëm emra. Se duhet me pas parasysh se për çdo regjistrim neve na kushton e ndoshta dikush po

përfiton e nuk e ka egzistent atë numër. Te përkrahja e klubeve te reja pajtona me profin, mirëpo me pas parasysh edhe sportet e tjera të reja që nuk ka në Istog.

Drejtoresha e Kulturës rinisë dhe sportit: Veç të ndërlidhna diçka qetu, Klubet sportive janë organizata dhe përderisa janë organizata dej ne momentin që ato nuk kanë përvojë 1 vjeçare, na si komune nuk kemi drejtë mi përkrah.

Ardon Arifaj, Zyrtar për Informim dhe Monitorim të Mediave: përnime është për keqardhje mungesa e klubeve që sot nuk jan këtu, edhe pse kanë pas ftesë me kon prezentë në këto dëgjime dhe i bien që me mos prezencë të tyre pajtohen me këtë rregullore.

Drejtoresha e Kulturës rinisë dhe sportit: Unë bashkë me Ardonin kemi marrë propozimet e paraqitura sot këtu dhe do ti shqyrtojmë.

Pasi që nuk pati me pyetje nga qytetarët drejtoresha Blakaj mbylli punimet e diskutimit publik me qytetarë dhe falënderoj ata për kohen e tyre që kishin ardhur për këtë draft rregullore.

Faleminderit shumë!

Procesmbajtës:
Ardon Arifaj, Zyrtar për Informim dhe Monitorim të Mediave